



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA ADMINISTRIMIT PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. _____ prot

Datë ____/____/2025

RELACION

Dhënie pelqimi për dhënien me qira të pasurise prej 1 ha ndodhur në ekonominë pyjore Mamëz-Kalimash, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës, n/ngastra: 57/a dhe 57/c, “Për vendosje kaminash për prodhim qymyr druri dhe eshkës së kovaqit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pikë transiti) etj”.

Bashkia Kukës në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore kjo sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, në lidhje me sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara nën administrim të saj gjithsej 40,068.38 ha.

Menaxhimi i aseteve është pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë. Bashkia Kukës ka një shtrirje gjeografike të gjerë që përfshin një sërë resursesh. Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Sipërfaqja e madhe pyjore e cila është në pronësi/administrim të Bashkisë Kukës dhe larmishmëria e terrenit e bëjnë të vështirë kontrollin e kësaj sipërfaqe pyjore dhe përdorimin e saj në mënyre të paligjshme.

Dhënia në përdorim e sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor të subjektet apo shoqëritë për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar sipas dispozitave ligjore ka një rol të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave të Bashkisë pasi në zbatim të Ligjit Nr. 57/2020 datë 30.04.2020, të gjitha të ardhurat që arkëtohen nga ushtrimi i aktiviteteve të subjekteve apo shoqërive private në fondin pyjor, do investohen në pyjeve me anë të projekteve për përmirësimin e pyjeve dhe zhvillimin e mjedisit.

Bashkia e ka të parashikuar dhe si objektiv në PPV zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore që sigurojnë: shtimin e sipërfaqeve pyjore rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë dëgradimin e mëtejshëm të tokës, mbrojnë biodiversitetin dhe e sigurojnë potencial maksimal për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global pa cënuar ekosisteme të tjera.

Menagjimi i aseteve

Në mbështetje të ligjit nr. 139, dt. 17.12.2015 për “Vetëqeverisje Vendore” (*i ndryshuar*), Ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2021 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (*i ndryshuar*), Ligji Nr 57/2020 “Per pyjet”, neni 12, neni 25 pika “a” e në vazhdim; V.K.M nr.433 datë. 08.06.2016 “Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrise se Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar me V.K.M Nr. 684, datë 02.09.2020 si edhe udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, Procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, propozojmë për dhënien në përdorim të pasurisë prej 0.63 ha n/ngastra nr. 57/a dhe 0.37 ha n/ngastra nr. 57/c, ndodhur në ekonominë pyjore Mamëz-Kalimash.

Kërkuesi Shoqëria: "CVMR Albania" sh.p.k me Administrator Theodor Laci, është drejtuar Bashkisë Kukës me një kërkesë në formën e propozimit të pakërkuar "Për marrjen me qira të një sipërfaqe pyjore" kërkesë praktike kjo me datë 26.05.2025. Bashkia Kukës duke vlerësuar kërkesën bazuar në pikën 3 të Udhëzimit të M.T.M nr 1/2016, njofton kërkuesin (Subjekt Juridik) se do ishte pjese e listes që do të propozohej për tu studjuar.

Kryetari i Bashkisë bazuar në pikën 4 të Udhëzimit nr 1/2016 te MM, me Urdhërin nr.1054 datë 23.06.2025, miraton dhe ngarkon Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për përgatitjen e studimit tekniko ekonomik.

Referuar Udhëzimit nr 1 dt 09.06.2016 për "Për rregullat, Procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave bazuar në pikat: 7 dhe 8, të Udhëzimit të mesipërm ka hartuar raportin tekniko-ekonomik të sipërfaqes prej 1 ha të cilën propozon për ta dhënë në përdorim.

Specialistët e Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, hartuan studimin dhe ja paraqitën këtë studim kryetarit të Bashkisë i cili me **Vendim nr. 44 datë 25/06/2025** e miraton këtë studim. Kjo në zbatim të pikës 6 të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.1 dt 09.06.2016 "Per rregullat, Procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", ku shprehimisht thuhet: "*kryetari i bashkisë miraton studimin teknik dhe procedurat për konkurimin publik.*"

Studimi i kryer përfshin sipërfaqen e fondit pyjor prej 0.63 ha n/ngastra nr. 57/a me zërin kadastral Pyll sipas planit të mbarështimit të hartuar në vitin 1985 ndërsa në realitet sipërfaqja pyjore rezulton të jete Djerr pasi është krijuar nga hedhja e inerteve për ndërtimin e Autostradës: "Morin-Milot", dhe 0.37 ha n/ngastra nr. 57/c me zërin kadastral Kullotë ndërsa në realitet sipërfaqja pyjore rezulton të jete Bimësi Pyjore. Referuar të dhënave kadastrale N/ngastrat pyjore ndodhen në ekonominë pyjore Mamëz-Kalimash.

Studimi përmban të dhënat hartografike shoqëruar me koordinatat e zonës, treguesit identifikues të ngastrës sipas të dhënave të regjistrit kadastral të përfshira në VKM nr 684/2020 "Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive".

Nr. Rendor Parcelar	Qarku	Bashkia	Kodi Kadastral	Ek. Pyjore	N/Ngastra	Katgoria e Përdorimit të territorit
1786	Kukës	Kukës	KU32 00 057/a	EP Mamëz-Kalimash	057/a	Pyll
1788	Kukës	Kukës	KU32 00 057/c	EP Mamëz-Kalimash	057/c	Kullotë

Gjendja ekzistuese e zonës, karakteristikat silvikulturale të grumbullit pyjor etj treguesit e vleres për dhënie me qera per ha/vit si dhe qëllimin e dhënies në përdorim.

"Për vendosje kaminash për prodhim gypur druri dhe eshkës së kovaqit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pikë transiti) etj". me një afat 10 (Dhjetë) vite.

Për qëllimin që propozohet nuk bie ndesh me parashikimin e planit të Përgjithshëm Vendor, ndërkohë që sipas këtij plani nuk parashikohen investime që mund të sjellin tjetërsim.

Në zbatim të VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore" shtojca 1 pika 12 percaktohen tarifat për ha të dhënies në përdorim, si dhe V.K.M Nr. 700 datë 13.08.2010 "Për miratimin e pagesave për ushtrimin e

gjuetisë, **Bazuar ne raportin tekniko-ekonomik, për sipërfaqen totale prej 1 ha. Vlera e plote per vitin e parë është: 274,500.0 lekë, ndërsa për vitin e dytë dhe në vazhdim, tarifa e cila duhet të paguaj Shoqëria është: 250,000.0 lekë.**

Për sa më sipër në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr 38/2019, kërkojmë nga Keshilli Bashkiak miratimin për: **Dhënie pëlqimi për dhënie me qira të pasurisë prej 1 ha për një afat 10 (Dhjetë) vite**, bazuar në studimin teknik dhe relacionin e paraqitur.

Pas shprehjes se Keshillit Bashkiak në parim atëherë vazhdohet me pikën 9 të Udhëzimit Nr. 1 datë 09.06.2016 sipas së cilës,

"... konkurimi publik për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor bëhet nëpërmjet shpalljes së njoftimit për konkurim publik në Buletinin e Prokurimit Publik, i cili përmban të dhënat për sipërfaqen, aktivitetin, vendin dhe adresën ku mund të tërhiqet dokumentacioni i nevojshëm si dhe datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit, sipas përcaktimeve ligjore."

Pas shpalljes së njoftimit, Kryetari i Bashkisë sipas pikës 12 të Udhëzimit, nxjerr Urdhërin për ngritjen e KVO-së. Kjo e fundit vendos për subjektin fitues dhe e njofton shpalljen në Buletin e PP.

Pas përfundimit të afatit të ankimit me subjektin brenda 10 ditëve lidhet kontrata e qirasë.

Kontrata tip është e miratuar nga ministri i Mjedisit.

DREJTORI

Sali Hallaçi